



Dokument për politikat publike -

Avancimi i qasjes në drejtësinë ekologjike:

Harmonizimi me standardet e Konventës së Aarhus-it

Shkup, 2024

Avancimi i qasjes në drejtësinë ekologjike: Harmonizimi me standardet e Konventës së Aarhus-it

Titulli i origjinalit:

Унапредување на пристапот до еколошка правда: усогласување со стандардите на архуската конвенција

Botues

Shoqata maqedonase e juristëve të rinj

Dizajni

Haris Muriq

Autorë

Bojan Trpevski

Vesna Dishlijovska

Përkthimi nga maqedonishtja

Rexhep Xheladini

Redaktore

Martina Drangovska Martinova

Vendi dhe viti i botimit

Shkup, 2024

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

502.17:341.24
349.6:340.137(497.7):341.24

TRPEVSKI, Bojan

Avancimi i qasjes në drejtësinë ekologjike [Електронски извор]: harmonizimi me standardet e konventës së Aarhus-it : dokument për politikat publike / [autorë Bojan Trpevski, Vesna Dishlijovska ; përkthimi nga maqedonishtja Rexhep Xheladini]. - Shkup : Shoqata maqedonase e juristëve të rinj, 2024

Начин на пристапување (URL):

<https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2024/12/ALB-Унапредување-на-еколошката-права-преку-правни-механизми.pdf>.

- Превод на делото: Унапредување на пристапот до еколошка правда: усогласување со стандардите на архуската конвенција : документ за јавни политики. - Текст во PDF формат, содржи 20 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 19.12.2024. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4843-93-1

1. Dishlijovska, Vesna [автор]

а) Животна средина -- Заштита -- Меѓународно-правна регулатива б)

Пристап до еколошка правда -- Архуска конвенција -- Усогласување -- Законска регулатива -- Македонија

COBISS.MK-ID 64969221

Ky dokument i politikave publike është përpiluar me ndihmën e projektit "Avancimi i drejtësisë ekologjike në Maqedoninë e Veriut" i siguruar nga Programi Global i UNDP-së për Forcimin e Sundimit të Ligjit, të Drejtave të Njeriut, Drejtësisë dhe Sigurisë për Paqe dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. Përmbajtja e këtij dokumenti të politikave publike është përgjegjësi vetëm e autorëve.

Përmbajtja

1

Shkurtesat

2

Hyrje

3

Standardet e Komitetit të
Konventës së Aarhusit për
Qasjen në Drejtësi

20

Konkluzione dhe rekomandime

Shkurtesat

VNM

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisin Jetësor

Konventa e Aarhusit

Konventa për qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet e mjedisit jetësor

AQLI

Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik

MMJPH

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

GJED

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

Hyrje



Mjedisi jetësor përfaqëson të gjithë ambientin e njeriut në të cilin ai jeton, punon dhe zhvillohet, prandaj mbrojtja e tij ka rëndësi të veçantë. Çdo organizëm i gjallë ka funksionin e tij në ekosisteme, ndaj mjedisi jetësor nuk duhet kuptuar vetëm si mbrojtje e ujit, ajrit dhe tokës, por duhet të ketë një shtrirje më të gjerë. Duke u nisur nga kjo, shoqëria ka zhvilluar të drejtën ndërkombëtare të gjerë për mbrojtjen e të gjitha aspekteve të mjedisit jetësor, e cila nga ana e saj paraqet bazën për zhvillimin e së drejtës kombëtare në këtë fushë. Krijimi i së drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor nuk do të përmbushë funksionin e saj nëse nuk zbatohet në mënyrë efektive.

Pikërisht zbatimi i së drejtës së mjedisit jetësor, konstatimi i mangësive dhe nevoja e ndryshimit të praktikës apo vetë kuadrit ligjor dhe institucional është detyrë e qasjes në drejtësi dhe veprimtarisë së organeve administrative apo gjyqësore. Mungesa e kontrollit mbi zbatimin e së drejtës në përgjithësi, por veçanërisht e së drejtës që rregullon mbrojtjen e mjedisit jetësor, mund të çojë në dëme afatgjata të vështira për t'u tejkaluar dhe të pariparueshme.

Rëndësia e qasjes në drejtësi në fushën e mjedisit reflektohet edhe në faktin se një nga tre shtyllat e Konventës të Aarhus-it jashtëzakonisht të rëndësishme është qasja në drejtësi. Kjo konventë, në nenin 9, tregon nevojën për qasje në drejtësi në: 1) procedurat për qasje në informacione lidhur me mjedisin jetësor, 2) pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje lidhur me mjedisin jetësor, 3) kur cenohet e drejta e mjedisit jetësor me akt ose lëshim.

Duke u nisur nga kjo dhe duke pasur parasysh se aktiviteti i individëve dhe organizatave të shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut tregon mangësi në qasjen në drejtësi dhe efikasitetin e mbrojtjes ligjore të mjedisit jetësor, ky dokument elaboron standardet për qasje në drejtësi që rrjedhin nga veprimtaria e Komitetit të Konventës së Aarhus-it dhe tregon aktivitetet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar situatën.

Standardet e Komitetit të Konventës së Aarhus-it lidhur me qasjen në drejtësi

Gjatë vlerësimit të përputhshmërisë me nenin 9 të Konventës, Komiteti i kushton vëmendje pasqyrës së përgjithshme të qasjes në drejtësi, përmes prizmit të objektivave të pasqyruara në preambulën e Konventës, gjegjësisht «mekanizmat gjyqësorë efektivë duhet të jenë në dispozicion të publikut, duke përfshirë organizatat, në mënyrë që të mbrohen interesat e tyre legjitime dhe e drejta të zbatohet». Komiteti shqyrton kuadrin e plotë ligjor dhe mundësitë e ndryshme për qasje në drejtësi që janë në dispozicion të publikut dhe organizatave në faza të ndryshme të procesit të vendimmarrjes. Gjatë konfirmimit nëse një vendim mund të kundërshtohet brenda kornizës së nenit 9, Komiteti nisat nga fuqia juridike dhe efekti i vendimit dhe jo nga emri i tij sipas të drejtës kombëtare.¹

“Pasqyra e përgjithshme” përfshinë në të njëjtën kohë edhe kuadrin ligjor për qasje në drejtësi në fushën e mjedisit jetësor të shtetit dhe zbatimin e saj në praktikë nga gjykatat. Aq më tepër që mundësia e zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare nuk duhet të jetë një justifikim për shtetin që të mos e transpozojë Konventën përmes një kuadri të qartë, transparent dhe konsistent. Komiteti nuk shqyrton vetëm nëse shteti i ka transpozuar fjalë për fjalë, fjalët e Konventës në të drejtën kombëtare, por merr parasysh edhe praktikën. Nëse dispozitat kombëtare mund të interpretohen në përputhje me kërkesat e Konventës, Komiteti shqyrton nëse provat e paraqitura në të tregojnë se praktika e gjykatave të shtetit ndjek në të vërtetë këtë qasje. Nëse nuk është kështu, Komiteti mund të konkludojë se shteti nuk është në përputhje me Konventën.²

Pikëpamjet e tilla tregojnë për rëndësinë e praktikës kur shqyrtohet përputhshmëria e shtetit me dispozitat e Konventës, kështu që fryma dhe qëllimi i Konventës duhet të merren gjithmonë parasysh nga organet administrative të nivelit të dytë që vendosin për ankesat, gjegjësisht gjykatat, kur veprojnë për çështje të lidhura me mjedisin jetësor.

¹ Bulgari ACCC/C/2011/58; ECE/MP.PP/C.1/2013/4, 11 janar 2013, paragrafi 52-53

² Gjermani ACCC/C/2008/31; ECE/MP.PP/C.1/2014/8, 4 janar 2014, paragrafi 64-65

Procedurat e rishikimit që do të vendosen në përputhje me nenin 9 paragrafin 1 të Konventës synojnë të korrigojnë mangësitë në procedurat për qasje në informacion në nivel kombëtar dhe si rregull i përgjithshëm, vetëm nëse shteti nuk e bën këtë brenda një periudhe të arsyeshme kohore, Komiteti mund të vazhdojë të marrë vendim për mospërputhje me Konventën.³ Komiteti thekson se kohëzgjatja e gjatë e procedurës për mbrojtjen e së drejtës dhe kontestimi i identifikimit aktiv të organizatës joqeveritare në procedurat gjyqësore për qasje në informacione lidhur me mjedisin jetësor nuk janë në përputhje me nenin 9 paragrafi 1 të Konventës.⁴

Legjislacioni në RMV ofron mekanizëm për mbrojtjen e së drejtës për qasje në informata përmes procedurës së ankesës para Agjencisë për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe padi para gjyqësisë administrative. Megjithatë, ndryshe nga procedura e ankimit, e cila mund të zgjasë 15 ditë, legjislacioni nuk përcakton një afat të saktë dhe konciz për përfundimin e procedurës gjyqësore, nëse ajo ka filluar. Përvoja e Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj tregon se procedurat e tilla ndonjëherë mund të zgjasin më shumë se 2 vjet, prandaj edhe rëndësia e këtij qëndrimi të Komitetit, i cili tregon një periudhë të arsyeshme kohore për përfundimin e procedurave.

Moldsilva nuk e ka respektuar vendimin përfundimtar të Këshillit Civil në Gjykatën e Apelit në Kishinau, e cila tregoi se kopjet e informacionit të kërkuar duhet t'i jepeshin parashtruesit. Nëse dikush ka mundësi të mos i bindet një vendimi gjyqësor të formës së prerë të marrë në përputhje me nenin 9 paragrafi 1 të Konventës, lindin pyetje në lidhje me natyrën detyruese të një vendimi të tillë gjyqësor në sistemin juridik. Duke marrë parasysh se neni 9 paragrafi 1 tregon se vendimet përfundimtare të gjykatave ose organeve të tjera të pavarura dhe autonome të krijuara me ligj janë të detyrueshme në natyrë dhe duhet të respektohen nga të gjithë, dështimi i **Moldsilva** për të zbatuar një vendim të tillë tregon mospërputhje nga shteti me nenin 9 paragrafi 1 të Konventës.⁵

³ Komiteti Evropian ACCC/C/2007/21; ECE/MP.PP/C.1/2009/2/Add.1, 11 dhjetor 2009, paragrafi 33

⁴ Kazakistan ACCC/C/2004/; ECE/MP.PP/C.1/2005/2/Add.1, 11 mars 2005, paragrafi 26

⁵ Moldavia ACCC/C/2008/30; ECE/MP.PP/C.1/2009/6/Add.3, 8 shkurt 2011, paragrafi 35

Në vitin 2022, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj iu drejtua një lëvizje joformale, kërkesa e së cilës për qasje në informacione me karakter publik nuk ka marrë përgjigje, kështu që parashtroi ankesë në AQLI, e cila e ka miratuar ankesën dhe e detyroi komunën që të jepte informacionin e kërkuar. Për shkak të moszbatimit të aktvendimit, në AQLI janë paraqitur disa ankesa, të cilat janë miratuar por puna nuk është kryer në mënyrë efektive në favor të parashtruesit.

Fillimi i një mosmarrëveshje administrative në një situatë të tillë do të ishte i pakuptimtë, sepse aktvendimi detyrues është në favor të parashtruesit të informacionit, kështu që padia ndoshta do të refuzohej, por duke marrë parasysh qëndrimin e Komitetit, e bazuar dhe në këtë rast mund të shtrohet pyetja për natyrën juridike të vendimeve të AQLI-së, gjegjësisht me respektimin e Konventës së Aarhus-it.

Për sa i përket qasjes në drejtësi, parashtruesit pretendojnë se atyre iu mohua qasja në një procedurë për të kundërshtuar ligjshmërinë materiale dhe procedurale të vendimit të qeverisë, e cila duhet të sigurohet në përputhje me nenin 9 paragrafin 2 të Konventës. Rëndësia e nenit 9 paragrafi 2 varet nga shkalla në të cilën neni 6 është i zbatueshëm, kështu që Komiteti konsideron se megjithëse vendimi fillimisht bie brenda fushëveprimit të vendimmarrjes së nenit 7, disa elementë bien brenda fushëveprimit të nenit 6, dhe për këtë arsye është i zbatueshëm neni 9 paragrafi 2.⁶ Komiteti konstaton më tej se duke dështuar në sigurimin e qasjes në procedurat e mbrojtjes ligjore dhe mjetet juridike adekuate dhe efektive për publikun e prekur, Qeveria e Armenisë nuk është në përputhje me nenin 9, paragrafët 2-4 të Konventës.⁷ Edhe pse përbën interes të mjaftueshëm dhe shkelje të së drejtës do të përcaktohet sipas ligjit kombëtar, duhet të vendoset «në mënyrë që të sigurohet qasje më e gjerë në drejtësi për publikun e prekur».⁸

6 Armenia ACCC/C/2004/8; ECE/MP.PP/C.1/2006/2/Add.1, 10 maj 2006, paragrafi 35

7 Ibid, paragrafi 44

8 Belgjika ACCC/2005/11; ECE/MP.PP/C.1/2006/4/Add.2, 28 qershor 2006, paragrafi 33

Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, në fushëveprimin e punës së saj për ofrimin e ndihmës juridike parësore, ka shpërndarë informacion në lidhje me procedurat e nisura nga anëtarët e publikut të prekur, për mbrojtjen e të drejtës së pjesëmarrjes të publikut, të përcaktuar nga neni 6 i Konventës, për shkak të mospublikimit të dokumenteve që mund të dorëzohen komente me shkrim, kur jepet leja për përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet një hidrocentrali të vogël. Procedurën për mbrojtje, parashtruesit e kanë filluar në vitin 2023 me ankesë në organin e shkallës së dytë, bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, por ajo është refuzuar si e kundërligjshme dhe e parakohshme. Procedura për mbrojtjen e kësaj të drejte është në Gjykatën Administrative.

Paragrafi i cituar i Komitetit është veçanërisht i rëndësishëm për procedura të tilla dhe duhet të merret parasysh nga të gjitha gjykatat kur vendoset për procedura të tilla ose të ngjashme.

Nga neni 2 paragrafi 5 rezulton se organizatat civile «që promovojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor» do të konsiderohen se kanë interes në marrjen e vendimeve në lidhje me mjedisin jetësor. Sipas nenit 9 paragrafi 2 i Konventës, çdo organizatë civile që plotëson kushtet e nenit 2 paragrafi 5 të Konventës do të konsiderohet se ka interes të mjaftueshëm dhe do të ketë legjitimitet aktiv në procedurat e shqyrtimit të ligjshmërisë. Prandaj, kushtet në të drejtën kombëtare që organizatat e shoqërisë civile duhet të promovojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor në mënyrë që të kenë legjitimitet aktiv, nuk janë në kundërshtim me Konventën. Megjithatë, për të qenë në përputhje me frymën dhe parimet e Konventës, këto kushte duhet të përcaktohen dhe zbatohen «me synimin për të siguruar qasje të gjerë në drejtësi për publikun e interesuar». Kjo do të thotë që kushtet e vendosura nga shteti duhet të përcaktohen qartë dhe nuk duhet të vendosin një barrë të tepruar për organizatat ekologjike/mjedisore të shoqërisë civile ose të aplikohen në një mënyrë që do të kufizojë ndjeshëm qasjen në drejtësi për organizata të tilla të shoqërisë civile.⁹

⁹ Gjermania ACCC/C/2008/31; ECE/MP.PP/C.1/2014/8, 4 qershor 2014, paragrafi 71

Në procedurën e lartpërmendur për mbrojtjen e së drejtës së pjesëmarrjes së publikut në miratimin e lejes së përdorimit të ujit, njëra prej tyre është iniciuar nga një organizatë civile ekologjike, por në vendimin për refuzimin e ankesës thuhet ndër të tjera se është dorëzuar nga një person i paautorizuar. Mund të vihet në pikëpyetje, duke pasur parasysh qëndrimin e Komitetit të cituar në këtë mënyrë, nëse autoritetet shtetërore e zbatojnë drejt Konventën, duke qenë se është një organizatë civile që është themeluar dhe punon për mbrojtjen e mjedisit jetësor, kështu që do të ishte e pajustificuar të konsiderohej se ankesa e paraqitur është paraqitur nga një person i paautorizuar. Është e padiskutueshme që ankesa mund të jetë vërtet e palejueshme apo e pabazuar, gjë që varet nga rrethanat specifike, por megjithatë lind pyetja në një situatë kur është paraqitur nga një organizatë ekologjike, a mund të konsiderohet se është paraqitur nga një person i paautorizuar, si dhe për këtë arsye të refuzohet.

Shteti nuk duhet, nëpërmjet legjislacionit apo praktikës, të vendosë kritere shtesë që do të kufizojnë qasjen në një procedurë për shqyrtimin e ligjshmërisë, si p.sh. duke kufizuar argumentet që parashtruesi mund të përdorë kur kundërshton vendimin. Megjithëse Konventa i referohet mjedisit jetësor, kur merret një vendim brenda fushëveprimit të nenit 6 të Konventës mund të jenë të shkelura, dispozitat që nuk promovojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dispozitat që lidhen me ndërtimin ose rindërtimin, aspektet ekonomike të investimeve, tregtisë, financave, prokurimit publik, etj. Prandaj, procedurat sipas nenit 9 paragrafi 2 të Konventës nuk duhet të kufizohen vetëm në shkeljet e pretenduara të ligjit kombëtar që «i shërben mjedisit jetësor», «ka lidhje me mjedisin jetësor» ose «promovon mbrojtjen e mjedisit jetësor» sepse nuk ka bazë ligjore për kufizime të tilla në Konventë. Komiteti konstaton se vendosja e një kushti që organizatat e shoqërisë civile ekologjike/mjedisore në mënyrë që të paraqesin një ankesë sipas EAA-së duhet të demonstrojnë se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me një dispozitë «që i shërben mjedisit jetësor» nuk është në përputhje me nenin 9 paragrafin 2 të Konventës.¹⁰

Pikëpamjet e tilla të Komitetit në përgjithësi duhet të merren parasysh nga të gjitha autoritetet (legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore) gjatë përgatitjes së legjislacionit, pra zbatimit të tij, i cili i referohet qasjes në drejtësi.

Komiteti thekson se neni 9 paragrafi 2 i Konventës lidhet drejtpërdrejt me nenin 6 i cili garanton të drejtën e publikut të prekur për të marrë pjesë në procedurat për lejimin e zbatimit të aktiviteteve specifike. Shtetet duhet të sigurojnë që në procedura të tilla publiku i interesuar mund të përdorë plotësisht të drejtën e tyre procedurale për pjesëmarrje të përcaktuar në nenin 6 të Konventës. Neni 9 paragrafi 2 në lidhje me nenin 9 paragrafi 4 të Konventës kërkon që shtetet t'i sigurojnë publikut të prekur qasje në mbrojtjen gjyqësore efektive të të drejtave të tyre procedurale sipas nenit 6, në rast se ato shkelen. Prandaj, nuk do të ishte në përputhje me Konventën t'i jepet mundësia vetëm teorikisht publikut të prekur që të kundërshtojë ligjshmërinë procedurale të vendimeve që përfshihen në kuadrin e nenit 6 dhe këto parashtresa të tyre të refuzohen sistematikisht nga gjykatat si të palejueshme ose të pabazuara ose për shkak se gabimet procedurale nuk janë materiale për vendimin (gjegjësisht se vendimi nuk do të kishte qenë i ndryshëm edhe nëse gabimet procedurale nuk do të kishin ndodhur lëshime). Komiteti është i shqetësuar për mungesën e qartësisë së sistemit juridik të shtetit nëse shkelja e të drejtave procedurale të parashikuara nga neni 6 do të përbënte një gabim themelor në procedurë që do të mundësonte ushtrimin e të drejtave sipas nenit 9 paragrafi 2 i Konventës. Komiteti thekson se nëse gjykatat gjermane refuzojnë të shqyrtojnë ankesat dhe/ose argumentet në lidhje me ligjshmërinë procedurale të vendimeve nga neni 6 të publikut të prekur, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, kjo do të ishte shkelje e nenit 9 paragrafi 2.¹¹

Pikëpamjet e tilla të Komitetit janë të një rëndësie të madhe në lidhje me procedurën e përmendur më parë për lejet e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, por edhe në përgjithësi për veprimet e institucioneve kur veprojnë për ankesa, gjegjësisht për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Vendimi për shqyrtimin në kuadër të VNM-së bie në kuadër të nenit 6 paragrafi 1 pika b të Konventës. Ky vendim i nënshtrohet kërkesave të nenit 9 paragrafi 2 të Konventës. Prandaj, publiku i prekur, siç përcaktohet në nenin 9 paragrafin 2 të Konventës, "do të ketë qasje në një procedurë përpara një gjykate dhe/ose organi tjetër të pavarur dhe autonom të krijuar me ligj, për të shqyrtuar ligjshmërinë materiale dhe procedurale të çdo vendimi, veprimi ose mosveprimi që i nënshtrohet dispozitave të nenit 6".¹²

¹¹ Ibid, paragrafi 82-83 dhe 90

¹² Mbretëria e Bashkuar ACCC/C/2010/45 и ACCC/C/2011/60; ECE/MP.PP/C.1/2013/12, 23 tetor 2013, paragrafi 83

Në korrik 2024, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe “Milieukontakt Maqedoni”- Qendra Aarhus, Shkup parashtruan ankesa kundër vendimeve për nevojën për VNM dhe shtrirjen e studimit për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10D, por nuk është marrë asnjë vendim për ato ende. Edhe pse e drejta e ankesës në legjislacionin maqedonas për vendime të tilla është e lejuar, lind pyetja për efektivitetin e kësaj të drejte dhe për këtë arsye respektimi i Konventës vihet në pikëpyetje, duke marrë parasysh qëndrimet e mëparshme, por edhe të tjera të Komitetit.

Nëse organizata civile promovon mbrojtjen e mjedisit jetësor mund të vlerësohet në disa mënyra, duke përfshirë por pa u kufizuar në dispozitat e statutit të saj dhe aktivitetet e saj. Shtetet mund të vendosin kushte brenda ligjit të tyre kombëtar, por këto kushte nuk duhet të jenë në kundërshtim me parimet e Konventës.¹³

Duke pasur parasysh se Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj në procedurën e iniciuar para gjykatave civile për konstatimin e shkeljes së të drejtave të njeriut për shkak të ndotjes së ajrit dhe menaxhimit të mbeturinave u përball, ndër të tjera, me sfida për legjitimitimin aktiv të shoqatës, ky qëndrim i Komitetit ka një rëndësi të madhe për gjykatat kur e shqyrtojnë këtë çështje.

Në përcaktimin e legjitimitetit aktiv brenda kornizës së nenit 9 paragrafi 2, Konventa i lejon shtetit, brenda kuadrit të ligjit të tij kombëtar, të përcaktojë nëse publiku ka një «interes të mjaftueshëm» dhe nëse ai mund të pretendojë se ka «shkelje të të drejtave», në rastet kur ligjet procedurale administrative e kërkojnë si parakusht. Kur bëhet fjalë për organizatat civile, Konventa ofron udhëzime të caktuara se si duhet të interpretohet «interesi i mjaftueshëm», por për personat, gjegjësisht «individët», Konventa kërkon që «interesi i mjaftueshëm» dhe «shkelja e të drejtave» të përcaktohet «në përputhje me kushtet në ligjin kombëtar». Për shkak të kësaj, shtetet gëzojnë një diskrecion të caktuar në përcaktimin e masës së publikut që ka identifikim aktiv në raste të tilla; por Konventa vendos më tej kufizime që kushte të tilla duhet të jenë në përputhje «me objektivat e sigurimit të qasjes të gjerë në drejtësi brenda kornizës së Konventës». Kjo do të thotë që shtetet, kur përdorin diskrecionin e tyre, nuk duhet t'i interpretojnë këto kushte në një mënyrë që do të zvogëlojë ndjeshëm volumin e personave që kanë identifikim aktiv dhe që bie ndesh me detyrimet e përgjithshme të neneve 1, 3 dhe 9 të Konventës.¹⁴

Në procedurën e përmendur më parë për kontestimin e lejes së shfrytëzimit të ujit, identifikimi aktiv vihet në pikëpyetje për shkak se ankesa është refuzuar për shkak se autoritetet konsiderojnë se është paraqitur nga një person i paautorizuar. Duke qenë se bëhet fjalë për një person që jeton në zonën ku do të ndërtohet hidrocentrali i vogël, por edhe duke qenë se nuk respektohen të drejtat e tij për pjesëmarrjen e publikut, autoritetet duhet të kenë parasysh këtë qëndrim të Komitetit në marrjen e një vendimi për identifikimin aktiv për paraqitjen e ankesës.

Parashtruesi i komunikimit argumenton se është e kotë të ofrohet qasje në drejtësi në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje pasi të ketë filluar ndërtimi. Megjithëse Komiteti nuk e pranon pikëpamjen se qasja në drejtësi në atë fazë është e pakuptimtë, nëse nuk ka mundësi për qasje në drejtësi në lidhje me ndonjë procedurë leje përpara momentit kur fillon ndërtimi, kjo definitivisht nuk do të ishte në përputhje me nenin 9 paragrafi 2 të Konventës. Qasja në drejtësi duhet të sigurohet kur është efektivisht e mundur të kundërshtohet leja për veprimtarinë në fjalë.¹⁵

¹⁴ Austria ACCC/C/2010/48; ECE/MP.PP/C.1/2012/4, 17 prill 2012, paragrafi 61

¹⁵ Komiteti Evropian ACCC/C/2006/17; ECE/MP.PP/2008/5/Add.10, 2 maj 2008, paragrafi 56

Në procedurën e përmendur më parë të iniciuar nga Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe “Milieukontakt Maqedoni”- Qendra Aarhus, Shkup për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10D, edhe pse qasja në drejtësi është e siguar, Komiteti në paragrafin e cituar tregon «efektivitetin» e qasjes në drejtësisë. Edhe pse legjislacioni maqedonas parasheh që kur paraqitet një ankesë, siç është rasti me procedurën e nisur, procedura e VNM-së nuk duhet të vazhdojë, gjegjësisht ndërtimi nuk duhet të fillojë, situata në terren është e ndryshme, prandaj çështja e efikasitetit mund të jetë të ngritura dhe efektiviteti i qasjes në drejtësi në raste të tilla dhe pajtueshmëria e shtetit me Konventën.

Megjithëse ligji i Republikës Çeke mund të mos jetë plotësisht i qartë dhe konsistent në lidhje me legjitimitimin aktiv të organizatave të shoqërisë civile, Komiteti vëren se organizatat e shoqërisë civile nuk mund të marrin pjesë gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, duke pasur parasysh se legjitimimi aktiv për organizatat e shoqërisë civile është kundër konkluzionit për VNM-në varet nëse ka shfrytëzuar më parë të drejtat [për të marrë pjesë] gjatë procedurës së VNM-së apo gjatë një procedure tjetër para dhënies së lejes/autorizimit. Komiteti konstaton se ligji çek i vendosur në këtë mënyrë kufizon të drejtën e organizatave të shoqërisë civile për të pasur qasje në një procedurë për të rishikuar ligjshmërinë e vendimit përfundimtar që lejon zbatimin e aktivitetit, siç është leja e ndërtimit. Në këtë drejtim, shteti nuk është në përputhje me nenin 9 paragrafi 2 të Konventës.¹⁶

Në procedurat e sipërpërmendura në lidhje me lejet e përdorimit të ujit, organi i shkallës së dytë, kur ka rrëzuar/refuzuar ankesat, e ka mbështetur, ndër të tjera, faktin se personat nuk kanë pasur statusin e palës në procedurë, sepse nuk kanë marrë pjesë në të. Kur vendoset në raste të tilla në të cilat qasja në përgjithësi në të drejtën e pjesëmarrjes së publikut kontestohet, nuk do të ishte në përputhje me qëndrimin e cituar më parë të Komitetit, që identifikimi aktiv të kufizohet vetëm nga fakti nëse personi ka marrë pjesë më parë në procedurë apo jo, sepse personi konteston se nuk ka pasur fare qasje në atë të drejtë.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit se ligji çek nuk parashikon kontrollin gjyqësor të konkluzioneve të shqyrtimit të procedurës së VNM-së, neni 6 paragrafi 1 pika b e Konventës kërkon që shtetet të përcaktojnë nëse aktivitetet që nuk janë brenda fushëveprimit të aneksit I, i cili mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në mjedis duhet të përfshihet në kuadrin e nenit 6. Prandaj, kur kjo përcaktohet rast pas rasti, autoritetet duhet të marrin një vendim që do të nxisë një detyrim për të zbatuar pjesëmarrjen e publikut në përputhje me nenin 6 ose do ta përjashtojë atë detyrim për aktivitetin specifik. Sipas ligjit çek, një vendim i tillë merret në kuadër të konkluzioneve të shqyrtimit në kuadër të VNM-së, prandaj Komiteti konsideron se një vendim i tillë bie në kuadër të nenit 6 paragrafi 1 pika b. Neni 9 paragrafi 2 i Konventës kërkon që shtetet të sigurojnë qasjen në një procedurë për të kundërshtuar ligjshmërinë materiale dhe procedurale të çdo vendimi, akti ose mosveprimi brenda kornizës të nenit 6. Këtu përfshihen detyrimisht vendimet dhe përcaktimet në kuadër të nenit 6 paragrafi 1 pika b. Prandaj, Komiteti konstaton se duke qenë se procesi i shqyrtimit në kuadër të VNMJ-së dhe kriteret përkatëse kanë funksionin e një vendimi në kuadrin e nenit 6 paragrafi 1 pika b, publiku i prekur duhet të ketë qasje në një procedurë për vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të shqyrtimit të procesit të VNM-së. Duke qenë se ky nuk është rasti në legjislacionin çek, Komiteti konstaton se shteti nuk është në përputhje me nenin 9 paragrafin 2 të Konventës.¹⁷



17

Çekia ACCC/C/2010/50; ECE/MP.PP/C.1/2012/11, 2 tetor 2012, paragrafi 82

Sipas Dekretit për përcaktimin e projekteve dhe mbi kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimeve mjedisore, projektet nga Aneksi 1 i Konventës «ndahen» në projekte për të cilat zbatimi i VNM-së është i detyrueshëm (Aneksi 1 i Dekretit) dhe projektet për të cilat vlerësohet rast pas rasti nëse kërkohet VNM- (Shtojca 2 e Dekretit). Vendimi nëse një projekt specifik ka nevojë për VNM apo jo, merret me vendim që kryhet në përputhje me nenin 81 të Ligjit për Mjedisin, i cili duhet të bëhet publik. Publiku i prekur ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi të tillë.

Edhe pse legjislacioni maqedonas është në përputhje me qëndrimin e cituar më parë të Komitetit, zbatimi i legjislacionit është sfidë. Më konkretisht, nëse MMJPH-ja vendos që nuk kërkohet VNM për një projekt që përfshihet në Aneksin 2 të Dekretit, një vendim i tillë nuk publikohet në ueb faqen e MMJPH-së, kështu që publiku i prekur nuk ka qasje në drejtësisë. Konfirmimi i këtij qëndrimi është se projektet e hidrocentraleve, të cilat logjikisht do të përfshinin hidrocentrale të vogla, janë të përfshira në projektet nga Aneksi 2 i Dekretit, kështu që praktika e MMJPH-së është që për këto projekte të mos realizohet një VNM, por duhet të hartohet dhe miratohet një elaborat në përputhje me nenin 24 të Ligjit për Mjedisin Jetësor por asnjë vendim i tillë nuk është publikuar në ueb faqen e MMJPH-së.

Sfidë shtesë është konflikti ndërmjet dekretit të përmendur më parë dhe dekreteve që përcaktojnë projektet për të cilat është hartuar në mënyrë të detyrueshme një raport për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga neni 24 i Ligjit për Mjedisin Jetësor, nëse merret parasysh fakti se vendimet për miratimin e raporteve të tilla nuk publikohet fare publikisht dhe as nuk rregullohet qasja në drejtësi të publikut të prekur në lidhje me to. Më konkretisht, projektet për ndërtimin e "autostradave", të cilat janë pjesë e Aneksit I të Konventës, janë "vendosur" në aneksin 1 të Dekretit për përcaktimin e projekteve dhe mbi kriteret mbi bazën e të cilave nevoja për të zbatuar procedura për vlerësimin e ndikimeve në mjedisin jetësor, pra projektet për të cilat zbatohet detyrimisht VNM-ja, por në të njëjtën kohë projekte të tilla gjenden edhe në Dekretin për veprimet dhe aktivitetet për të cilat është përgatitur detyrimisht elaborat, për miratimin e të cilit përgjigjet autoriteti për kryerjen e punëve profesionale në fushën e mjedisit jetësor, si projektet për të cilat hartohet elaborat i detyrueshëm. Kjo situatë mund të shkaktojë një situatë në të cilën, nëse merret parasysh se Ligji për Mjedisin Jetësor nuk parashikon pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje apo qasje në drejtësi gjatë miratimit të elaborateve, do të përgatitet një raport për një autostradë pa kryer një procedurë shqyrtimi për VNM-në dhe publiku i prekur praktikisht nuk ka qasje në drejtësi, në kundërshtim me Konventën dhe qëndrimin e Komitetit.

Prandaj, shteti duhet ta ketë parasysh këtë qëndrim të Komitetit me rastin e ndryshimit të praktikës së zbatimit të Ligjit për mjedisin jetësor, ndryshimit të nenit 24 të Ligjit për mjedisin jetësor në drejtësi të sigurimit të pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në drejtësi me rastin e miratimit të elaborateve për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe rishikimin e duhur të dekreteve që rregullojnë projektet për të cilat duhet të përgatitet një VNM, gjegjësisht një raport për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Kur vendoset se si të kategorizohet një vendim sipas Konventës, emri i tij sipas ligjit kombëtar nuk është vendimtar, përkundrazi, nëse vendimi duhet të kundërshtohet sipas nenit 9 paragrafi 2 ose 3 vendoset duke u bazuar në funksionin ligjor dhe efektin e vendimit, gjegjësisht nëse përbën një leje për fillimin e veprimtarisë.¹⁸ Dispozita e nenit 9 paragrafi 3 synon t'i sigurojë publikut qasje në mjetet juridike adekuate kundër veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet e mjedisit jetësor dhe t'u sigurojë atyre një mjet për zbatimin dhe efektivitetin e ligjeve të mjedisit jetësor. Kur vlerësohen kushtet belge për qasjen në drejtësi për organizatat e shoqërisë civile përmes prizmit të nenit 9 paragrafi 3, dispozitat duhet të lexohen në lidhje me nenin 1 paragrafi 3 të Konventës në drejtim të qëllimit të pasqyruar në preambulë, gjegjësisht mekanizma efektivë ligjorë që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë organizatat, me qëllim që të mbrohen interesat e tyre legjitime dhe të zbatohet ligji».¹⁹

Organizata Front 21/42 gjatë vitit 2021 ka iniciuar procedurë për shkak të pjesëmarrjes joadekuate të publikut në procedurën e vlerësimit strategjik të mjedisit, më konkretisht mospublikimit të draft planit urbanistik për të cilin është bërë vlerësimi strategjik. Publikimi i projektplanit urbanistik në kuadër të procedurës së vlerësimit strategjik është obligim sipas Ligjit për Mjedisin Jetësor dhe thelbi i tij është që publiku të ketë qasje në informacione që do të mundësonin përfshirjen e tij thelbësore në vendimmarrje. Për shkak të lëshimit të bërë nga një komunë, organizata ka paraqitur një kundërshtim në komunë, e cila në kundërshtim me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, në vend të zgjidhjes është përgjigjur me njoftim për refuzim të kundërshtimit. Kundër njoftimit të tillë organizata ka iniciuar një kontest administrativ, i cili është ende në vazhdim, por në procedurën paraprake padia është hedhur poshtë për shkak se Gjykata Administrative ka konsideruar se njoftimi nuk paraqet akt juridik individual kundër të cilit mund të fillohet kontest administrativ.

Qëndrimi i cituar i Komitetit është i rëndësishëm sepse, megjithëse është e padiskutueshme se njoftimi nuk përfaqëson një akt juridik individual, duke pasur parasysh se kundërshtimi është hedhur poshtë me njoftim, tregon se sipas funksionit dhe natyrës juridike, ai përfaqëson në fakt një zgjidhje. Prandaj, në raste të tilla, gjykatat duhet të zbatojnë qëndrimin e Komitetit dhe të shikojnë natyrën juridike dhe funksionin e aktit kontestues, e jo ekskluzivisht të shikojnë titullin e dokumentit të kontestuar.

¹⁸ Belgjikë ACCC/2005/11; ECE/MP.PP/C.1/2006/4/Add.2, 28 korrik 2006, paragrafi 29

¹⁹ Ibid, paragrafi 34

Është e qartë për Komitetin se neni 230 paragrafi 4 i Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (TKE-së), mbi të cilën Gjykata e Drejtësisë e BE-së mbështet qëndrimin e saj të rreptë mbi identifikimin aktiv, është shkruar në një mënyrë që mund të interpretohet në drejtim të ofrimit të identifikimit aktiv për individët dhe organizatat civile sipas standardit të nenit 9 paragrafi 3 i Konventës. Megjithatë, nga rastet e paraqitura nga parashtruesi i komunikatës rezulton se për t'u prekur individualisht, sipas GJED-së, duhet të preket gjendja juridike e personit për shkak të gjendjes faktike që e dallon atë nga të gjithë personat e tjerë. Prandaj, personi nuk mund të preket nëse vendimi ose rregullorja zbatohet për një situatë objektive juridike ose faktike. Pasojat e aplikimit të testit Plauman²⁰ në lidhje me çështjet mjedisore dhe shëndetësore është se praktikisht asnjë anëtar i publikut nuk do të jetë në gjendje të kundërshtojë vendimin ose rregulloren në një rast të tillë përpara GJED-së.²¹

Në vitin 2021, qytetarët e mbështetur nga Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike kanë iniciuar çështje gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm nga neni 43 i Kushtetutës për shkak të ndotjes së ajrit, përpara gjyqësorit administrativ. Propozimet e paraqitura në këtë drejtim u refuzuan dhe ndër të tjera Gjykata Administrative konstatoi se në rastet e nisura nuk ka interes individual por interes të përgjithshëm, pra masat që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore nuk do të referohen vetëm në mënyrë specifike ndaj kërkuesve, por do të ketë një efekt të përgjithshëm pozitiv.

Prandaj, qëndrimi i cituar i Komitetit duhet të merret parasysh kur vendoset në përgjithësi për rastet e iniciuara dhe veçanërisht se ai vë në pah si problematik, për sa i përket harmonizimit me Konventën, standardin e tepruar të vërtetimit të interesit individual.

²⁰ Në çështjen Plauman, e cila u vendos në vitin 1963, GJED-ja, duke interpretuar nenin 230 të TKE-së, konstatoi se «personat që nuk preken nga një vendim mund të pretendojnë se janë të interesuar individualisht nëse ai vendim i prek ata për shkak të attributeve specifike për ta ose për shkak të rrethanave në të cilat ato dallohen nga të gjithë të tjerët dhe nëse këta faktorë i ndajnë ato individualisht si në rastin e personit me të cilin [vendimet] lidhen»

²¹ Bashkimi Evropian ACCC/C/2008/32 (pjesa I); ECE/MP.PP/C.1/2011/4/Add.1, maj 2011, paragrafi 86

Konventa nuk i referohet «ligjeve ekologjike» por «ligjeve që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor». Neni 9 paragrafi 3 nuk kufizohet në «ligjet ekologjike», pra ligjet që përfshijnë shprehimisht termin «mjedis jetësor» në titullin ose dispozitat e tij, por mbulon të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, gjegjësisht ligjet brenda kornizës së çdo politike, duke përfshirë por jo edhe kufizuar në kontrollin kimik dhe menaxhimin e mbetjeve, planifikimi, transporti, minierat dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore, bujqësisë, energjisë, taksave ose çështjeve detare, të cilat në përgjithësi mund të lidhen ose të ndihmojnë për të mbrojtur, dëmtuar ose ndikuar ndryshe në mjedisin jetësor.²² Ligjet që lidhen me mbrojtjen e specieve të egra dhe/ose tregtinë e specieve të rrezikuara (përfshirë marketingun vendas, importin dhe eksportin) janë gjithashtu «ligje që kanë të bëjnë me mjedisin» sepse ato nuk kufizohen në marrëdhëniet tregtare, por përfshijnë dhe detyrime se si kafshët/llojet duhet trajtuar dhe mbrojtur. Prandaj, këto ligje ndihmojnë në mbrojtjen ose ndikojnë ndryshe në mjedisin jetësor.²³

Një qëndrim i tillë i Komitetit zë një vend të rëndësishëm dhe duhet të merret parasysh kur vendoset për rastet e mundshme që do të jenë para gjykatave ose organeve të tjera administrative që veprojnë për ankesat.

Komiteti konsideron se përtej fushëveprimit të procedurave të VNM-së dhe lejeve të integruara ekologjike dhe dëmtimit ekologjik, kushtet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar të shtetit janë aq të rrepta sa që ato në mënyrë efektive i pengojnë organizatat e shoqërisë civile të jenë në gjendje të kundërshtojnë aktet dhe mosveprimet që janë në kundërshtim me ligjin kombëtar lidhur me mjedisin jetësor. Fakti që ekziston mundësia që procedurat e përcaktuara nga ligjet sektoriale të mjedisit jetësor mund të konsolidohen sipas procedurave të VNM-së dhe lejeve mjedisore të integruara për projekte të mëdha, ose që dëmi mjedisor dhe mjetet juridike civile në kushte të caktuara janë të zbatueshme, nuk kompenson mospërputhjen e detyrimit nga neni 9 paragrafi 3 në lidhje me aktet veprimet dhe lëshimet e tjera.²⁴

²² Austria ACCC/C/2011/63; ECE/MP.PP/C.1/2014/3, 13 janar 2014, paragrafi 52

²³ Ibid, paragrafi 55

²⁴ Austria ACCC/C/2010/48; ECE/MP.PP/C.1/2012/4, 17 prill 2012, paragrafi 73

Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj ka iniciuar raste gjyqësore para gjykatave civile me qëllim që të konstatohet shkelje e të drejtave të njeriut si rezultat i situatës në mjedisin jetësor dhe moszbatimit të legjislacionit në lidhje me cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave. Prandaj, procedura të tilla kualifikohen brenda kuadrit të nenit 9 paragrafi 3 të Konventës. Nga ana tjetër, Qendra për Kërkime dhe Analiza Ligjore ka mbështetur disa çështje në Gjykatën Administrative, të cilat kërkojnë konstatimin e shkeljes së të drejtës për një mjedis jetësor të shëndetshëm si pasojë e moszbatimit të së drejtës për cilësinë e ajrit dhe si rrjedhim edhe këto procese bien në kuadrin e nenit 9 paragrafi 3 të Konventës. Të gjitha procedurat e nisura kanë përfunduar, edhe pse disa prej tyre janë ende në vazhdim, me vendime refuzuese.

Prandaj, paragrafi i cituar është veçanërisht i rëndësishëm për gjykatat dhe në mënyrë indirekte jep drejtim se si ligji duhet të interpretohet dhe zbatohet përmes prizmit të Konventës.

Shteti thekson rëndësinë e Avokatit të Popullit për mjedisin jetësor dhe mundësinë që publiku, i përfshirë organizatat e shoqërisë civile, t'i drejtohen Avokatit të Popullit për kërkesat e tyre. Komisioni vëren se sipas tabelës së përgatitur nga parashtuesi i komunikimit dhe me të cilën shteti është pajtuar, kompetenca e Avokatit të Popullit për Mjedisin Jetësor është e kufizuar për faktin se ai nuk ka legjitimitetin aktiv në shumë ligje sektoriale që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor përveç procedurave të VNM-së, lejeve të integruara ekologjike, dëmtimit ekologjik, procedurave të ruajtjes së natyrës dhe menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka diskrecionin nëse do ta çojë rastin në gjykatë apo jo, pavarësisht nga kërkesat e publikut, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile. Komiteti konstaton se shteti, duke mos siguruar legjitimitet aktiv për organizatat e shoqërisë civile për të kundërshtuar veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve publike ose të personave privatë që janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit kombëtar lidhur me mjedisin jetësor, nuk është në përputhje me nenin 9 paragrafi 3 të Konventës.²⁵

Nëse marrim parasysh procedurat e përmendura më parë të Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Qendrës për Hulumtime Juridike dhe rezultatin e këtyre procedurave gjyqësore, qëndrimi i cituar i Komitetit është i rëndësishëm nga pikëpamja që Avokati i Popullit, i cili si në Austri, si dhe në Maqedoninë e Veriut, ka kompetenca të kufizuara, nuk mund të zëvendësojë mungesën e procedurës gjyqësore, gjegjësisht sigurimin e identifikimit aktiv për organizatat e shoqërisë civile brenda kërkesave të nenit 9 paragrafi 3 të Konventës.

Shteti ka miratuar ligje ekologjike në nivel federal, kurse shtetet kanë autoritetin për të zbatuar dhe ekzekutuar ligjet. Qasja në drejtësinë ekologjike rregullohet kryesisht në nivel federal. Sipas parimeve të vendosura mirë të së drejtës procedurale gjermane, që rrjedhin nga doktrina e “shkeljes të së drejtës”, qasja në drejtësi garantohet në bazë të faktit nëse parashtruesi pretendon se i janë shkelur disa të drejta subjektive. Një zbatim i rreptë i këtij parimi në qasjen në drejtësi sipas Konventës do të sillte mospërputhje me nenin 9 paragrafin 3 të Konventës, duke pasur parasysh se shumë shkelje të kryera nga autoritetet publike ose individët privatë nuk mund të kundërshtoheshin nëse nuk vërtetohej se një shkelje e tillë shkel një të drejtë subjektive. Kërkesa për shkeljen e një të drejte subjektive në shumë raste do t’i pengonte organizatat e shoqërisë civile të kenë qasje në procedurë, duke qenë se ato hyjnë në procese gjyqësore në interes të publikut. Në vendimin e tij të datës 5 shtator 2013, i cili pason vendimin e GJED-së në çështjen “Slovak Brown Bear”, Gjykata Federale Administrative zgjeroi interpretimin e kriterit të “shkeljes të së drejtës”. Megjithatë, kjo është bërë për të siguruar zbatimin e saktë të legjislacionit përkatës të BE-së dhe nuk nënkupton, as garanton, që një interpretim i tillë do të zbatohet nga gjykatat në ato fusha të së drejtës kombëtare që janë relevante për Konventën e Aarhus-it, por nuk mbulohet nga legjislacioni i BE-së se ky interpretim do të ndiqet gjerësisht në vendime të tjera. Gjykata Federale Administrative tregoi se që Gjermania të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 9, paragrafi 3 i Konventës, janë të nevojshme ndryshime ligjore. Nëse një interpretim i gjerë i «shkeljes së një të drejte subjektive» do të bëhej praktikë e përgjithshme e gjykatave gjermane në të gjitha fushat e së drejtës kombëtare që i intereson Konventës, kjo do të përbënte përputhje me Konventën. Megjithatë, në mungesë të garancive ligjore për publikun, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, për të pasur qasje në një procedurë për të kundërshtuar veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve publike dhe individëve privatë në fushat e ligjit kombëtar në lidhje me mjedisin jetësor, me përjashtim të kuadrit të EAA-së, Ligji Federal për ruajtjen e natyrës dhe Ligji për dëmtimin e mjedisit jetësor, Komiteti konsideron se kushtet e vendosura nga shteti nuk ofrojnë legjitimitet aktiv për organizatat e shoqërisë civile ekologjike për të sfiduar veprimet dhe mosveprimet që janë në kundërshtim me ligjet kombëtare në lidhje me mjedisin jetësor. Për këto arsye, Komiteti konstaton se duke mos siguruar legjitimitet

aktiv të organizatave të shoqërisë civile ekologjike në shumë prej ligjeve sektoriale, për të kundërshtuar veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve publike ose të personave privatë që janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit kombëtar në lidhje me mjedisin jetësor, shteti ka dështuar të jetë në përputhje me nenin 9 paragrafin 3 të Konventës.²⁶

Një qëndrim i tillë i Komitetit është i rëndësishëm nëse merren parasysh procedurat e iniciuara nga Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe Qendrës për Hulumtime Juridike, të cilat përfunduan me vendime refuzuese, sepse ato procedura sfidojnë zbatimin e përgjithshëm, gjegjësisht dështimin për të ndërmarrë veprime në drejtim të zbatimit të ligjit dhe ndikimit të tyre në të drejtat e njeriut. Procedurat e Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj janë veçanërisht të rëndësishme për qëndrimin e lartpërmendur, për faktin se në to shoqata paraqitet si paditëse, ndërsa legjitimitimi aktiv i saj është kontestuar.

Qëndrimi i cituar i Komitetit është i rëndësishëm edhe për procedurat lidhur me lejet e përdorimit të ujit, të cilat u përmendën në këtë dokument, sepse evidenton rrezikun e interpretimit të “shkeljes të së drejtës” ndaj qasjes të gjerë në drejtësi.

Konkluzionet dhe rekomandimet



Legjislacioni dhe praktika e RMV-së përballet me një sërë sfidash kur bëhet fjalë për qasjen në drejtësi në fushën e mjedisit jetësor, parë nga prizmi i Konventës së Aarhus-it dhe standardeve të vendosura nga Komiteti i Konventës.

Nevojiten debate të gjera dhe ekspertësh për të përmirësuar qasjen në drejtësi në këtë fushë duke ndryshuar, plotësuar dhe përmirësuar legjislacionin.

Është e nevojshme që gjykatat dhe organet administrative që vendosin për ankesat e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të njohin mirë standardet e qasjes në drejtësi në përputhje me Konventën e Aarhus-it dhe në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës dhe të zbatojnë ata në përputhje me vendimet e tyre.

